

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	SPAK refuzon kërkesën e Veliajt për të marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak - Euronews Albani a
ADRESA	https://euronews.al/spak-refuzon-kerkesen-e-veliajt-per-te-marre-pjese-ne-mbledhjen-e-ke-shillit-bashkiak/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 08:56:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 08:55:12 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	44e4ef475c81c01a7e9c668a26e657bd0917cb8fd388404d7e5e30c1031b9e71
TEKSTI	e53425057db89e9470981fbef2dd428e3fdab3d5a8a817f9da286f8428f5d04d
PAMJA	77123bfd64176e6b2d328f627a43a273f02c5d9fb51dedcdab1737ce76a74411

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e5b8b7b57646943325f8cc1bee8a6629a0b2bb1eecd34dca8290a5e3d0261d26
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5542c6f376d7530e05241a95b291e64e02f5f89d799222f37a26423635f8fe31
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e5b8b7b57646943325f8cc1bee8a6629a0b2bb1eecd34dca8290a5e3d0261d26>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Lufta në Iran BE France Francë Marco Rubio

AKTUALITET | LAJM KRYESOR

SPAK refuzon kërkesën e Veliajt për të marrë pjesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak

29 Shtator 2026 | 10:55

SPAK ka refuzuar kërkesën e Këshillit Bashkiak të Tiranës për të mundësuar praninë e kryebashkiakut Erion Veliaj në mbledhjen e sotme, e planifikuar për orën 15:00.

Këshilli Bashkiak kishte kërkuar që Veliaj të lejohej të merrte pjesë fizikisht në mbledhje ose, në pamundësi të kësaj, të lidhej përmes videokonferencës. Kërkesa ishte dërguar pranë SPAK-ut dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Sipas informacionit, refuzimi i SPAK është bërë në bazë të dispozitave të ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", që përcakton të drejtat dhe trajtimin e personave që ndodhen në paraburgim, si dhe kompetencat e institucioneve përgjegjëse.

Këshilli Bashkiak kishte argumentuar se prania e kryetarit ishte e rëndësishme për shqyrtimin e çështjeve që lidhen me administrimin e Bashkisë së Tiranës, ndërsa në rendin e ditës së mbledhjes së sotme është përfshirë edhe diskutimi mbi projektligjin për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore.

Në kërkesën drejtuar institucioneve, Këshilli Bashkiak iu referua edhe vendimit nr. 66, datë 3 nëntor 2025, të Gjykatës Kushtetuese, duke argumentuar se pjesëmarrja e kryetarit në mbledhjet e Këshillit lidhet me ushtrimin e funksioneve të tij institucionale.

Veliaj ndodhet në paraburgim dhe vijon të jetë nën masën e arrestit në burg. Më 15 shtator, Gjykata e Lartë ia në fuqi masën e sigurisë ndaj tij, pas rishqyrtimit të çështjes në zbatim të një vendimi të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | VENDI

LAJMI I FUNDIT

10:55 **Aeroplani iranian sekuestrohet në Stamboll për shkak të një borxhi prej 3 milionë eurosh**

10:49 **FMN dhe Banka Botërore vlerësojnë sektorin financiar shqiptar, Sejko takohet me misionin e përbashkët**

10:44 **Kryetari i parlamentit iranian: Asnjë infrastrukturë rajonale nuk do të jetë e sigurt nëse siguria e Iranit nuk garantohet**

10:42 **Tensionet për ishujt Falkland SHPERNDAJE ARTIKULLIN**
Briten, Argjentina kërcënon Britaninë me betejë ligjore

10:34 **Meloni kalon provën e zgjedhjeve të pjesshme kundër rivalit të ri të ekstremit të djathtë**

10:33 **Qeveria britanike e konfirmon: Hyrja falas në muzetë kombëtare do të vazhdojë**

TESTIM

AKTUALITET | VENDI

I dënuar për vrasje me paramendim, kapet në Itali 28-vjeçari shqiptar

Një 28-vjeçar shqiptar i shpallur në kërkim ndërkombëtar për vrasje me paramendim është arrestuar në Bolzano të Italisë, në kuadër të operacionit policor të koduar...

10:16 | 29/09/2026

AKTUALITET | VENDI

Lëvizi me makinë në trotuar dhe e postoi në TikTok, gjobitet me 60 mijë lekë dhe i hiqet leja e qarkullimit shoferit në Berat

Është ndëshkuar me 60 mijë lekë këtë të martë një qytetar në Berat, pasi me automjet ka lëvizur në trotuar duke rrezikuar këmbësorët dhe më...

09:44 | 29/09/2026

AKTUALITET | VENDI

Shiste kokainë në lokalin që kishte marrë me qira, arrestohet 57-vjeçari në Korçë

Një 57-vjeçar është arrestuar nga Policia e Korçës, pasi dyshohet se në lokalin që kishte marrë me qira, në fshatin Drithas, shiste kokainë. Sipas raportimeve...

09:18 | 29/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontaktoni
Punësimi

Follow Euronews on all platforms: